



REPUBLIKA E SHQIPERISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E ÇËSHTJEVE JURIDIKE

Nr. 717 / Prot
2

Tiranë, më 17 / 19 / 2015

Lënda: *Jepet mendim në lidhje me shtimin e listës tip të dokumentave të klasifikuara "Sekret Shtetëror".*

Drejtuar: **MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME**
Z. Genci GJONÇAJ
Sekretar i Përgjithshëm

Tiranë

Në përgjigje të shkresës Nr.4986 Prot, datë 31.07.2015, nëpërmjet të cilës kërkohet mendim mbi shtimin e dy zërave 1) "materiali filmik (audio/video)" dhe 2) *prova filmime (audio/video)* në listën tip të dokumenteve të klasifikuara "Sekret Shtetëror" të cilët do të përftoheshin gjatë zbatimit të projektit "Sistem Multifunksional i kamerave të trupit për patrullat e Policisë së Shtetit", ju bëjmë me dije se Zyra e Komisionerit nuk është e njohur me përmbajtjen e vetë këtij projekti.

Në nenin 31/1/a të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, thuhet, 1) "Komisioneri është përgjegjës për a) dhënien e mendimeve për projekt-aktet, ligjore dhe nënligjore, që kanë të bëjnë me të dhënat personale, si dhe projektet që kërkohen të zbatohen nga kontrolluesit vetëm apo në bashkëpunim me të tjerë".

Gjithashtu, neni 32/1 i ligjit të sipërpërmendur, ju detyron të bashkëpunoni me Zyrën e Komisionerit dhe ti siguronit atij të gjithë informacionin e nevojshëm për konsultimin me projektet përpara implementimit të tyre.

Në këtë qëllim u kërkua edhe takimi me përfaqësues të institucionit tuaj, takim i cili nuk ja arriti qëllimit të kërkuar.

Për arsyet e lartpërmendura, Zyra e Komisionerit gjendet në pamundësi të dhënies së vlerësimit për objektin e kërkesës tuaj në raport me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

Në këto kushte, në funksion të rolit monitorues dhe inspektues të institucionit në implementimin e këtij projekti dhe të tjerëve të zhvilluar në Administratën Publike, ju informojmë mbi disa rregulla e kritere që duhet të vlerësoni për rastin në fjalë.

Lejimi i zhvillimit dhe implementimit të këtij *Projekti* në përputhje me ligjin nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, *kërkon* domosdoshmërisht parashikimin e qartë dhe specifik të qëllimit të mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave nëpërmjet CCTV.

Projekti në bazë studimi do të duhet të ketë arritur të evidentojë përdorimin e këtij mjeti si mënyra e fundit për të arritur qëllimin mbi të cilin ai është hartuar dhe do të realizohet, madje paramendohet të mundësojë rezultate të pritshme krahasimisht me arritjet pa përdorimin e këtij mjeti. Kjo, për faktin se përpunimi i të dhënave të subjekteve lidhet ngushtësisht me cënimin e privatësisë së tyre dhe impaktin që shkaktohet në rast të pasojave.

Në rastin konkret, kontrolluesi Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, trajtohet si “kontrollues i madh” dhe për këtë shkak detyrohet të përmbushë detyrimet e parashikuara në udhëzimin nr.21, datë 24.09.2012 të Komisionerit, “*Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga subjektet përpunuese të mëdha*”, i ndryshuar.

Kontrolluesi përpara përdorimit të këtij mjeti do të duhet të bëjë njoftimin përkatës në përputhje me nenin 21 e në vijim të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Projekti, apo rregulla të veçanta dalë në zbatim të tij, do të duhet/n të ketë mirë përcaktuar kategorinë e përpunuesve të të dhënave personale, mënyrat e përdorura për informimin e subjekteve të cilëve do ti mblidhen dhe përpunohen të dhënat si dhe duhet të ketë parashikuar kohën e mbajtjes së tyre dhe mënyrën e shkatërrimit në përfundim të përmbushjes së qëllimit.

Projekti duhet të parashikojë masat e sigurisë që do të përdoren për të mos keqpërdorur të dhënat e mbledhura, mos i përhapur ato, etj.

Projekti duhet të parashikojë mënyrat e lejimit të individëve për të ushtruar të drejtat e tyre, deri te e drejta për të kundërshtuar mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave personale.

Projekti duhet të ketë vlerësuar rastet e transferimit, transmetimit të dhënave apo edhe përhapjes së tyre, nëse do të ketë veprime të kësaj natyre.

Projekti duhet të ketë parashikuar nivelin e aksesit në të dhënat e mbledhura si dhe kategorinë që do të aksesojë.

Projekti duhet të ketë parashikuar përdorimin e këtij mjeti në mbrojtje të interesit të rëndësishëm publik dhe jo përdorimin e tij për raste të pretendimeve apo konstatimeve të shkeljeve administrative.

Kur është evident fakti që do të ketë edhe përdorim të pajisjeve audio, cënimi i privatësisë mund të jetë më i rrishtuar dhe për këtë është e nevojshme që projekti të ketë parashikuar standarde të nivelit të lartë të masave të sigurisë. Udhëzimi nr.3, datë 05.03.2010 i Komisionerit, “Mbi përpunimin e të dhënave personale me sistemin e Video Survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera” i ndryshuar, parashikon rregulla mbi përpunimin e të dhënave personale si dhe kohën e mbajtjes së të dhënave, duke lejuar tejkalim të afatit dy mujor të parashikuar në këtë udhëzim, vetëm për rregjistrimet e bëra nga policia por gjithnjë në përputhje me legjislacionin specifik mbi të cilin ky organ është ngritur dhe funksionon.

Pra. afatet kohore të mbajtjes së të dhënave lidhen ngushtësisht me qëllimin e mbledhjes së tyre, me përfundimin e qëllimit duke u parashikuar edhe shkatërrimi në rast të mos argumentimit për tejkalim të afatit të mbajtjes sipas parashikimit të udhëzimit të lartpërmendur.

Në rast të konstatimit se, mbledhja e të dhënave dhe ekspozimi i pautorizuar i tyre mund të rrezikojnë sigurinë kombëtare/ ti shkaktojnë dëme serioze sigurisë kombëtare, atëherë në përputhje me ligjin nr. 8457, datë 11.02.1999 "Për informacionin e klasifikuar "Sekret Shtetëror", informacionet mund të konsiderohen dokumente të klasifikuara "Sekret Shtetëror" dhe për rrjedhojë mund ti nënshtrohen nivelit të klasifikimit të kërkuar dhe më tej edhe afatit të ruajtjes së klasifikimit. Në shkresën përcjellëse evidentohet se mund të mblidhen të dhëna në mënyrë rastësore. Këto të dhëna nuk mund ti nënshtrohen nivelit të klasifikimit të kërkuar dhe për rrjedhojë edhe afatit të ruajtjes së klasifikimit.

Pasqyrimi/përfshirja e këtyre të dhënave që kërkohet të bëhet, në Urdhërin nr. 341, datë 1.10.2010 "Për listën tip të dokumenteve të klasifikuara "Sekret shtetëror", i Ministrisë të Brendshme, kërkon vlerësim të kujdesshëm dhe parë ngushtë edhe me të drejtat themelore që individët gëzojnë dhe që do të duhet të ushtrojnë gjatë kohës kur të dhënat e tyre përpunohen nëpërmjet këtij mjeti, si e drejta e informimit dhe ajo e të drejtës së ankimit, gjë e cila nuk mund të arrihet në mënyrë përgjithësuese.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

Besnik DERVISHI

KOMISIONERI
